



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 284₂ prot.

Tiranë, më 07.07.2024

URDHËR
Nr. 24, datë 07.07.2024

PËR
KOORDINIMIN DHE BASHKËRENDIMIN E INSPEKTIMEVE NË FUSHËN E
PËRDORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Në zbatim të shkronjës a, të nenit 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 96, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”¹, i ndryshuar, Kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, me fokus të veçantë uljen e barrës administrative ndaj biznesit në veprimtaritë me objekt inspektimin mbi menaxhimin e integruar të burimeve ujore;

URDHËROJ:

1. Koordinimin dhe bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT).
2. Inspektimet të kryhen me dokumente standarde, *online*, në sistemin elektronik “e-Inspektimi” dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit në marrjen e masës administrative.
3. Inspektorati Qendror (IQ) do të koordinojë dhe bashkërendojë veprimtaritë inspektuese të trupave inspektuese, sipas përcaktimeve në Kreun IV, të VKM nr. 696/2013.
4. Ngarkohen AKM, IKMT dhe IQ për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKELQIM HAJDARI

¹ deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 29/2024, “Për burimet ujore”